



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastitu Okoline

Department for Urbanism, Planning and Environment Protection

PROCESVERBAL


Nga takimi i shqyrtimit publik me qytetarë për Draft-Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034, me fokus banorët e fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor.

Data: 10.08.2026

Ora: 13:30

Vendi: Objekti i Shkollës Filllore në Çifllak

Tema: Prezantimi dhe shqyrtimi publik i Draft-Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034, me fokus banorët e fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq dhe Mrasor



Të pranishëm:

- **Albnor Mullabazi** – Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- **Shpejtim Mustafa** – zyrtar i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- **Selim Metkambberi** – Shef i Sektorit të Urbanizmit;
- Qytetarë dhe banorë të fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor dhe zonave përreth.

Takimin e hapi Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, i cili fillimisht falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe interesimin e tyre për procesin e shqyrtimit publik të Draft-Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034.

Në fjalën hyrëse, drejtori theksoi se qëllimi i takimit është që qytetarëve t'u mundësohet të njihen më nga afër me përmbajtjen e Draft-Hartës Zonale, veçanërisht me pjesën hartografike, si dhe të kenë mundësi që gjatë periudhës së shqyrtimit publik të paraqesin komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Ai sqaroi se ky takim nuk ka karakterin e prezantimit të përgjithshëm të dokumentit, sikurse prezantimi i bërë në hapjen e shqyrtimit publik në sallën e Kuvendit Komunal, por është organizuar me qëllim që qytetarët, në mënyrë më konkrete dhe praktike, të mund të shohin hartat dhe zonat që lidhen drejtpërdrejt me vendbanimet dhe pronat e tyre.

U bë e ditur se më 12.08.2026, në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit, do të bëhet prezantimi i Draft-Hartës Zonale nga kompania hartuse, ku qytetarët do të kenë mundësi të marrin informacione më të detajuara dhe të parashtrojnë pyetje e komente lidhur me dokumentin.

Drejtori sqaroi se Draft-Harta Zonale përbëhet nga: pjesa tekstuale, dhe pjesa hartografike.

Në këtë takim, fokusi kryesor ishte në pjesën hartografike, me qëllim që qytetarët të kenë mundësi të identifikojnë zonat dhe destinimet e propozuara në territorin e vendbanimeve të tyre.

Prezantimi i hartës së shfrytëzimit të tokës

Më pas, drejtori Albnor Mullabazi ia dha fjalën zyrtarit Shpejtim Mustafa, i cili përmes projektorit prezantoi Hartën e Shfrytëzimit të Tokës.

Gjatë prezantimit u bë e ditur se harta paraqet, përmes ngjyrave dhe përcaktimeve përkatëse, zonat dhe destinimet e ndryshme të shfrytëzimit të tokës në territorin e Komunës së Rahovecit.

Prezantimi u fokusua fillimisht në territorin e fshatit Çifllak, dhe më pas në zonat e Polluzhës, Dobidolit, Kramovikut, Gurit të Kuq, Mrasorit dhe zonave përreth, duke u orientuar sipas kërkesave dhe interesimit të qytetarëve të pranishëm.

Gjatë prezantimit u sqarua se Draft-Harta Zonale përcakton zonat e shfrytëzimit të tokës dhe krijon bazën për përcaktimin e kushteve dhe parametrave për zhvillimin e parcelave dhe zonave të caktuara.

Gjithashtu, u sqarua se përveç Hartës së Shfrytëzimit të Tokës, Draft-Harta Zonale përmban edhe harta të tjera tematike dhe hartografike, të cilat trajtojnë fusha dhe aspekte të ndryshme të planifikimit hapësinor.

Qytetarëve iu bë e ditur se gjatë periudhës së shqyrtimit publik kanë mundësi të paraqesin kërkesat, komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre lidhur me përmbajtjen e dokumentit, veçanërisht për zonat dhe parcelat me të cilat kanë interes të drejtpërdrejtë.

Në përfundim të takimit, Albnor Mullabazi i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre, duke i ftuar që të shfrytëzojnë periudhën e shqyrtimit publik për të paraqitur me kohë komentet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre lidhur me Draft-Hartën Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034.

U theksua se kontributet e qytetarëve janë të rëndësishme për përmirësimin dhe plotësimin e dokumentit para përfundimit të procedurave ligjore për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Takimi përfundoi në frymë konstruktive dhe me dakordim që diskutimet dhe konsultimet me qytetarë të vazhdojnë edhe në takimet e tjera të planifikuara gjatë periudhës së shqyrtimit publik.

